

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rama me diasporën në New York: Shqipëria nuk ka më nevojë për ndihma! Sazani dhe Zvërneci, projekt e të jashtëzakonshme
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/rama-me-diasporen-ne-new-york-shqiperia-nuk-ka-me-ne-voje-per-ndihma-saz-i588631
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 19:56:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 19:53:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	43cbfdd1f95d7ba7e02d89adcdf226beef7381b067f954217936ac5b74b7dd36
TEKSTI	cb1a0e0730fea9b72610d607c44411792b2bbb203cde20eaa344a14dd96df311
PAMJA	43dd09be403e20ba616243205711145dda568bfe64a3c7046601171203ce24e4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7b04c541b50f10dbbadba9aca3d88d50e6ab74a79fd8753d941184f18d317beb
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	20cb9bc098b6b22129b01f41a10ad3ad7e12cceb89fa0b5f21647847572e06c6
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7b04c541b50f10dbbadba9aca3d88d50e6ab74a79fd8753d941184f18d317beb>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by

English

le Rama me diasporën në New York: Shqipëria nuk ka me nevojë për ndihma! Sazani dhe Zverneci, projekte të jashtëzakonshmeShqipëria nuk fal ndaj Bjellorusisë, kuqezit fundit

Rama me diasporën në New York: Shqipëria nuk ka më nevojë për ndihma! Sazani dhe Zverneci, projekte të jashtëzakonshme



26 Shtator 2026, 21:53Politika TEMA



Kryeministri Edi Rama zhvilloi një takim me komunitetin shqiptar në Staten Island të Nju Jorkut, gjatë vizitës së tij në Shtetet e Bashkuara për Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së. Në fjalën para të pranishmëve, ai u ndal te marrëdhënia me diasporën, investimet në Shqipëri dhe zhvillimi i turizmit, ndërsa komentoi edhe protestat që e shoqëruan gjatë qëndrimit në SHBA.

Rama tha se lidhja mes Shqipërisë dhe shqiptarëve jashtë vendit ka kaluar nga mbështetja përmes dërgesave financiare në një marrëdhënie më të gjerë, që përfshin investime, bashkëpunim dhe rikthime. Duke kujtuar diskutimet që i paraprinë Samitit të parë të Diasporës, ai vlerësoi kontributin e emigrantëve në ekonominë e familjeve shqiptare.

"Pavarësisht se jemi në SHBA, ky është një territor jo i pushtuar zyrtarisht nga shqiptarët. Në vitin 2015 unë isha në një darkë shqiptarësh i ftuar, sëbashku me Hashim Thaçin dhe në atë darkë u diskutua për herë të parë ideja e atij që një vit më pas u bë Samiti i parë i Diasporës në Tiranë. 10 vite prej atij Samiti, besoj se kanë ndodhur plotë gjëra pozitive dhe lidhja e Shqipërisë me Diasporën është kthyer në një lidhje ku janë ngritur ura që kalojnë interesat, investime dhe plotë rikthime shqiptarësh në tokën ëmë. 90 % e familjeve shqiptare kanë përfutur të paktën njëherë nga dërgesat financiare të shqiptarëve të Diasporës. Ky është një nder i madh që do ta mbulojë me lavdi diasporën shqiptare të gjithë këtyre viteve. Por siç e thashë, nuk jemi më në atë fazë, kur diaspora jepte e Shqipëria merrte, por jemi në një tjetër fazë.

Kemi nisur të krijojmë një regjistër kombëtar të Diasporës, për të gjitha ata që duan të investojnë sadopak në Shqipëri. Ky ndryshim që ka ndodhur në këtë marrëdhënie, s'ka ndodhur thjeshtë aty ku ta rrok syri, por ka ndodhur në mendësi. Tani jeta është shumë më organike dhe pjesë e atij organiciteti ishin edhe vezët që m'u hodhën mua. Madje, një nga hedhësit e vezëve kishte ardhur nga Anglia për të hedhur vezë. Shpresoj të ketë kaluar mirë me Policinë e Nju Jork. Në trupën e mbrojtjes pastaj që u angazhua në çdo event, ishte një shqiptar që shërben në Policinë e Nju Jork. Prandaj unë u ndodha komplet në shtëpi, edhe Policia, edhe protestuesit. Këtu u prit me një tortë rozë, që kishte 2 flamingo si një zemër. Më erdhi mirë. Shqipëria nuk vuan më tani faktin që zogjtë e kafshët vriten dhe askush nuk shqetësohet për to. Shqipëria e sotme nuk është më Shqipëria në nevojë për ndihma. Sot Shqipëria ka hëpur një derë të re, derën e maleve të saj", tha mes të tjerash Rama.

Në vijim, kryeministri foli për synimin që Shqipëria të tërheqë turistë që shpenzojnë më shumë, duke e orientuar sektorin drejt asaj që e quajti turizëm të vlerës. Në këtë kuadër, ai përmendi projektet e parashikuara në Sazan dhe Zvernec, të cilat i cilësoi të rëndësishme për ekonominë shqiptare.

Sipas Ramës, projekti në Zvërnec parashikon një investim prej më shumë se katër miliardë eurosh. Ai pranoi se ndërhyrjet janë delikate për ekuilibrin mjedisor dhe tha se qeveria po punon për një studim mbi ndikimin dhe risqet e tyre. Njëkohësisht, kryeministri akuzoi për manipulim dhe përhapje gënjeshtresh një pjesë të zërave kundër projekteve në rrjetet sociale.

“Këtë synim ka projekti i shumë diskutuar, projekti i famshëm, por edhe fatkeq për fat të keq, si rezultat i shumë gënjeshtreve, manipulimeve, denigrimeve. Projekti i Sazanit dhe Zvërnecit, një projekt që sjell vetëm në Zvërnec më shumë se 4 miliardë euro, në një ekonomi që në totalin e vet është 27 miliardë euro. Një projekt i jashtëzakonshëm për Shqipërinë. Është jashtëzakonisht delikat edhe në aspektin e ekuilibrit për mjedisin, prandaj ne po punojmë shumë për të pasur një studim për ndikimin dhe risqet në mjedis. Risqet reale dhe jo ato që prodhohen në rrjetet sociale nga sharlatanët e manipulatorët. Shpresoj që kur të vini në Shqipëri, kryepolici të na japë mundësi që të takohemi. Para se të vija këtu, më mori në telefon Dritani nga Mali i Zi, ish-kryeministri dhe miku im i shtrenjtë, i vetmi qytetar i botës në Ballkan, i cili më tha ‘shiko se atje ku po shkon, te ajo dallga shqiptare, ke edhe disa shukumë nga Ulqini. Kështu që shumë faleminderit’, tha mes të tjerash Rama.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

["Na ndërpreu takimin dhe mallkoi banorët", Braçe reagon pas përplasjes me aktivisten](#)

19:40 Politika / 10 komente

[Komisioni Hetimor për zgjedhjet e 11 majit, PD kërkon nisjen e procedurave: Vendimi i Kushtetueses është detyrues](#)

17:40 Politika / 1 koment

Wendt në Tiranë, ambasada amerikane zbardh detaje pas takimit me Begaj: Diskutuan për çuarjen përpara të përparësive të administratës Trump

16:30 Politika / 7 komente

"Shkova bashkë me Argitën" - E akuzoi se ka kaluar nga zyra e Agasit, Berisha "zbythet" ndaj ministres Ismaili: Ishte

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.